



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
KËSHILLI I BASHKISË KLOS

Nr. 358 Prot

Klos, më 7.12/2023

VENDIM

Nr: 85 datë 26.12.2023

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PBA 2025-2027 DHE TË
BUXHETIT TË VITIT 2025”

Këshilli i Bashkisë Klos në mbledhjen e datës 26.12.2023, Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 33 paragrafi 1 të ligjit nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Këshilli i Bashkisë Klos mori në shqyrtim P/Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerzore, Çeshtjeve Juridikedhe Shërbimeve Finaciare, diskutoj rreth tij dhe në përfundim me **13 (trembëdhjetë)** vota pro:

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të përgatitjes së PBA 2025-2027 dhe të buxhetit të vitit 2025, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Afati	Zbatuesi
1	Ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik	Deri më 31.01.2024	Nëpunësi Autorizues
2	Përgatitja e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm 2025-2027 të të ardhurave dhe paraqitja e këtij raporti nga Kryetari i Bashkisë në Këshill. Duhet të përfshihet metodologjia e përdorur për parashikimin afatmesëm të të ardhurave, analiza të efektshme të politikave të reja fiskale, analiza e risqeve dhe masat e marra për përballimin e tyre	Deri më 31.01.2024	Spektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave
3	Miratimi i Raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2025-2027	Deri më 28.02.2024	Këshilli Bashkiak
4	Ngritja e Ekipit të Menaxhimit të Programeve	Deri më 05.03.2024	Nëpunësi Autorizues
5	Njohja me udhëzimin e Ministrisë së Financave të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe parashikimi i	Deri më 10.03.2024	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues EMP



	tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2025-2027.		
6	Paraqitja e tavaneve buxhetore në Këshillin bashkiak për miratim.	Deri më 15.03.2024	Nëpunësi Zbatues DEMP
7	Përgatitja e Projekt-dokumentit të PBA-së 2025-2027 dhe dërgimi në Ministrinë e Financave	Deri më 01.06.2024	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues EMP
8	Shqyrtimi i raportit të rekomandimeve të dërguara nga Ministria e Financave dhe përgatitja e projekt-dokumentit të rishikuar dhe dërgimi për miratim në Këshillin Bashkiak.	Deri më 20.06.2024	GMS
9	Publikimi i dokumentit të parë të miratuar të PBA-së 2025-2027	Deri më 05.07.2024	GMS
10	Përgatitja e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së dhe dërgimi në Këshillin Bashkiak për miratim	Deri më 20.07.2024	Nëpunësi Zbatues EMP
11	Përgatitja e projekt-dokumentit të PBA-së të rishikuar bashkë me informacionin mbi rekomandimet e lëna nga MF dhe dërgimi në Ministrinë e Financave	Deri më 15.09.2024	Nëpunësi Zbatues GMS
12	Shqyrtimi rekomandimeve përfundimtare të dërguara nga MF dhe përgatitja e PBA 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025 dhe dërgimi në Këshillin Bashkiak për miratim.	Deri më 30.11.2024	Nëpunësi Zbatues GMS
13	Miratimi i PBA-së 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025	Deri më 25.12.2024	Këshilli Bashkiak
14	Publikimi i dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor.	Deri më 31.12.2024	Nëpunësi Zbatues

- Vendimi hyn në fuqi , pasi të shprehet dhe Prefekti i Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.
- Ngarkohet për zbatimin e vendimit Drejtoria e Burimeve Njerzore, Çeshtjeve Juridike dhe Shërbimeve Finaciare.
- U shpallë sot me date 27.12/2023

SEKRETARI I KËSHILLIT
Etmond DEMIRI



KRYETARI I KËSHILLIT
Hazbie DEDOLLI





Handwritten signature and date: 27.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1278/1 prot.

Peshkopi, më 29.12.2023

Lënda: Për vendimin nr.85, datë 26.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Klos.

BASHKISË KLOS

KLOS

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Klos nr.85, datë 26.12.2023 **“Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së PBA 2025-2027 dhe të buxhetit të vitit 2025”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e financës e probleme të ngjashme me to nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Klos që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

